



Implementuar nga  
**giz** Deutsche Gesellschaft  
für Internationale  
Zusammenarbeit (GIZ) GmbH

Në bashkëpunim me



Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural  
Ministarstvo Poljoprivrede, Šumarstva i Ruralnog Razvoja  
Ministry of Agriculture, Forestry and Rural Development

Si një organizatë ndërkombëtare e bashkëpunimit në fushën e zhvillimit të qëndrueshëm, e shtrirë në mbarë botën, organizata federale Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH përkrahë Qeverinë e Gjermanisë në arritjen e objektivave të saj zhvillimore. Kjo organizatë ofron zgjidhje të qëndrueshme dhe me perspektivë për zhvillimin politik, ekonomik, ekologjik dhe shoqëror në një botë të globalizuar. GIZ-i avancoi reforma komplekse dhe procese të ndryshimit. Objektivi i saj i përgjithshëm është përmirësimi i qëndrueshëm i kushteve të jetesë së njerëzve.

Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH shpall si në vijim:

## Ftesë për aplikim

Projekti i GIZ-it “Konkurueshmëria e Sektorit Privat në Zonat Rurale” (COSIRA) i realizuar në bashkëpunim me Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe të Zhvillimit Rural (MBPZHR) fton individët e kualifikuar dhe me përvojë që të aplikojnë për trajner me qëllim të fuqizimit të nismave për Zhvillim Regjional Rural dhe Ekonomik (ZhRRE). GIZ-i dhe MBPZHR planifikojnë të krijojnë një ekip të trajnerëve vendorë, të cilët do të përkrahin grupet lokale të veprimit, MBPZHR-në, GIZ-in dhe organizatat e tjera në përpjekjet e tyre për të avancuar ZhRRE-në.

Individët e përzgjedhur do të kalojnë një program të trajnimit për trajnerë që do të zgjas 15 ditë, si dhe do të kontribuojnë në zhvillimin e mëtejshëm të materialeve ekzistuese të trajnimit. Programi i trajnimit të trajnerëve do të realizohet nga dy ekspertë ndërkombëtarë dhe një ekspert vendor. Pas përfundimit të suksesshëm të programit të trajnimit të trajnerëve, individët do të marrin nga një certifikatë të lëshuar nga GIZ-i dhe MBPZHR-ja, përmes së cilës atyre do t'u mundësohet ofrimi i trajnimeve për institucionet anëtare që janë aktive në nismat e ZhRRE-së.

Ky angazhim kërkon diplomë fakulteti në një nga fushat relevante (bujqësi, administrim biznesi, menaxhim, ekologji, ekonomi, mjedis, pylltari, zhvillim rural, gjeografi, socio-ekonomi, turizëm, veterinari ose të ngjashme), të paktën dy vjet përvojë pune në zhvillimin rural, bujqësi apo zhvillim biznesi. Vetëm individët privatë apo nga shoqëria civile mund të merren parasysh për këtë ftesë për aplikime.

Individët e interesuar ftohen që të marrin pjesë në një **takim informues**, i cili do të organizohet më **1.7.2015, 16.00-17.00 h** në zyrat e GIZ-it, rr. Anton Çetta në Prishtinë, ku do të marrin informata më të hollësishme rreth programit të trajnimit dhe procesit të aplikimit. Nga pjesëmarrësit kërkohet që të konfirmojnë pjesëmarrjen e tyre në këtë takim informues deri më datën 30.06.2015 përmes një e-mail-i dërguar tek [lindita.musaj@giz.de](mailto:lindita.musaj@giz.de), të titulluar “Takimi informues për procesin e certifikimit të trajnerëve të ZhRRE-së”. Për ata që nuk mund të marrin pjesë në takimin informues, informatat e dhëna në këtë takim do të ofrohen në faqen vijuese të internetit: [www.facebook.com/groups/HCD4RRED](http://www.facebook.com/groups/HCD4RRED).

Afati i fundit për dorëzimin e aplikacioneve është 12.07.2015. Formularin e aplikimit dhe informatat e tjera për procesin e aplikimit mund t'i gjeni në [www.facebook.com/groups/HCD4RRED](http://www.facebook.com/groups/HCD4RRED).

Në bazë të rezultatit të procesit të përzgjedhjes, GIZ-i do të nënshkruajë një marrëveshje me individët e përzgjedhur. GIZ-i do t'i mbulojë shpenzimet e trajnimit dhe të ushqimit gjatë realizimit të moduleve të trajnimit. Nëse ka nevojë, do t'i mbulojë edhe shpenzimet e fjetjes.